



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Construmax" Sh.P.K. të datës 16.05.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "97 Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën Agim Ramadani" me nr. të prokurimit 616-24-3786-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Construmax" Sh.P.K. e datës 16.05.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "97 Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën Agim Ramadani" me nr. të prokurimit 616-24-3786-5-1-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Construmax" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Construmax" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 16.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "97 Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën Agim Ramadani" me nr. të prokurimit 616-24-3786-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1: “Kapaciteti teknik dhe profesional - Kerkesa 2. Lista e punëtorëve të OE duhet të ketë min. 100 punëtor të punësuar me kontrata të rregullta të punës apo me marrëveshje për angazhim, prej të cilëve së paku 20 punëtor duhet të jenë të certifikuar për siguri dhe shëndet në punë. Kjo kërkesë është diskriminues dhe favorizues për kompani të caktuar, për arsye që është e panevojshëm të prezentohen 100 punëtor me kontrata të parregullëta apo me marrëveshje, për arsye që në DT është parapar që OE do të prezentoj planin dinamik, po ashtu në DT është e parapara edhe mundësia e angazhimeve të nënkontraktorëve, dhe është e panevojshëm dhe numër i madhë i punëtorëve të kërkuar. Po ashtu bazuar edhe në punimet që do të bëhen janë punime kryesisht që kryhen me makineri dhe numëri kaq i madhë i punëtorëve i kërkuar mund të jetë edhe pengës për punë. Andaj duke analizuar proejktin dhe punët që do të kryhen, kërkojm që kjo kërkesë të zbritet në maksimumi të prezentohen 30 punëtor, pasi që janë të mjaftueshëm për kryerjen e këtyre punimeve”.

Pretendimi 2: “Ju tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, tek Kërkesat Kapaciteti teknik dhe profesional - Kerkesa 3. Një (1) Arkeolog i diplomuar me së paku 10 vite përvojë të punës profesionale pas diplomimit Kjo kërkesë është diskriminues dhe favorizues për kompani të caktuar, për arsye që është e panevojshëm të prezentohen një arkeolog me përvojë 10 vjeqare, për arsye që nëse punkryesi vëren elemente arkeologjike në punishte, do të njoftoj investitorin, dhe ineqsitori institucionet kopetente për kete punë. Andaj kërkojm largimin e këtij kriteri, pasi që është i panevojshëm dhe diskriminues, po ashtu kjo bie ndesh për arsye që supozojmë as në grupin mbikqyrës të ineqsitorit nuk ka arkeolog dhe si do të raportoj arkeologu kur nuk ka mbikqyrës arkeolog. Gjithashtu në paramas dhe projekt nuk ka ndonjë evidencë që kemi të bëjmë me punime arkeologjike”.

Pretendimi 3: “Një (1) Ekspert për Restaurimin e Monumenteve me së paku 10 vite përvojë të punës profesionale pas diplomimit Kjo kërkesë është diskriminues dhe favorizues për kompani të caktuar, për arsye që është e panevojshëm të prezentohen një ekspert për restaurimin e monumeteve me përvojë 10 vjeqare, për arsye që nëse punkryesi vëren që është e nevojshme restaurim të monumenteve në punishte, do të njoftoj investitorin, dhe ineqsitori institucionet kopetente për kete punë. Po ashtu nuk është i precizuar se për qfar eksperti është fjala, dhe qfar kualifikimi është i nevojshëm. Andaj kërkojm largimin e këtij kriteri, pasi që është i panevojshëm dhe diskriminues, po ashtu kjo bie ndesh për arsye që supozojmë as në grupin mbikqyrës të ineqsitorit nuk ka ekspert për restaurimin e monumenteve dhe si do të raportoj ky ekspert kur nuk ka mbikqyrës arkeolog. Gjithashtu në paramas dhe projekt nuk ka ndonjë evidencë që kemi të bëjmë me punime arkeologjike”.

Pretendimi 4: “Një (1) Auditor i brendshëm i kualitetit të sistemit menagjues, i cili është trajnuar dhe qertifikuar në bazë të parimeve të ISO 9001 2015. Ky person kryen kontrollin e procedurave në kompani dhe është përgjegjës të jokonformiteteve të gjetura, ti evidentoj dhe ti eliminoj ato, kontrollon aktivitetet - projektet sa i përket cilësisë. Kjo kërkesë është diskriminues dhe favorizues për kompani të caktuar, për arsye që është e panevojshëm të prezentohen një auditor i trajnuar dhe certifikuar në bazë të parimeve ISO 9001 2015, për arsye që Kërkesën 9 të DT është e kërkuar që OE të prezentoj që është i certifikuar me ISO 9001 2015. Andaj kërkojm të largohet ky kriter për arsye që nëse kompani është e certifikuar qka do të i duhej një të certifikuar, kur dihet që e gjithë kompania është e certifikuar. Kërkesa për dëshmi të kërkuara dokumentare për stafin profesional - 4. Kontrata e punës e noterizuar apo marrëveshja për angazhim e noterizuar (kopja e noterizuar jo më e vjetër se 6 muaj), Diploma Master apo Bachelor- kopja e noterizuar jo më e vjetër se 6 muaj;

Konsiderojmë që kërkesa për kontrat të noterizuar apo marrveshje për angazhimin e noterizuar, është e pa nevojshme, për arsye që ofertuesi mund të dëshmoj me dëshmi të deklarimeve në ATK, po ashtu mund të dëshmoj me kontrat origjinale apo marrveshje origjinale. Gjithashtu kërkesa që diploma të jetë e noterizuar jo më shumë se 6 muaj, është kërkesë e pa arsyeshme dhe diskriminuese, pasi që dihet që stafi profesional në momentin që diplomon dhe paiset me diplomë nuk mund të ndryshoj atë diplomë, dhe noterizimi duhet të jetë i vlefshëm i qfardo kohet prej momentin të aprovimit të ligjit noterial në Republikën e Kosovës. Andaj kërkojmë që të largohen dëshmia dokumentare për kontrata të noterizuara apo marrveshje si dhe të largohet kërkesa e noterizimit jo më e vjetër se 6 muaj, për arsye që janë diskriminuese dhe të pa arsyeshëm me konceptin e procedurës tenderuese”.

Pretendimi 5: *“Kërkesa për dëshmi të kërkuara dokumentare për të gjitha kërkesat 5,6,7,8,9 të largohet kërkesa që kopja e noterizuar të jetë jo më e vjetër se 6 muaj, pasi që është kërkesë e pa arsyeshme dhe diskriminuese, pasi që dihet që këto certifikata, licenca dhe diploma në momentin që lëshohen dhe paiset me ato nuk mund të ndryshohen, dhe noterizimi duhet të jetë i vlefshëm i qfardo kohet prej momentin të aprovimit të ligjit noterial në Republikën e Kosovës. Andaj kërkojmë që të largohen kërkesa për kopje të noterizuar jo më të vjetër se 6 muaj”.*

Pretendimi 6: *“Kërkesa për ISO 1452-1 2009, ISO 50001 2018, ISO 3834-2 2006, EN ISO 39001 201, BS EN 13331-1 2002, PAS 99 2012, SA 8000 2014, janë kërkesa të panevojshëm dhe nuk kanë të bëjnë me nevojën e kësaj procedure tenderuese, dhe janë kërkesa që kufizojnë konkurrencën apo edhe përcaktojnë fituesin”.*

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se parashtruesi ka kontestuar rreth gjysmën ose më shumë prej kërkesave teknike dhe profesionale në dosjen e tenderit me pretendimin se ato janë diskriminuese. Megjithatë parashtruesi nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo argument të vetëm sipas të cilit do të mund të argumentohet qoftë edhe pjesërisht ndonjëri prej pretendimeve ankimore.

Sa i përket aktivitetit të prokurimit, duhet sqaruar faktin se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me një nga projektet më të mëdha dhe më të rëndësishme që janë bërë ndonjëherë në Komunën e Prishtinës për fushën e infrastrukturës rrugore dhe jo vetëm. Pra është mjaft e domosdoshme që të garantohej në mënyrë absolute efikasiteti dhe efektiviteti përkatësisht suksesi i impletimit të kontratës që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Në frymën e këtij qëllimi por edhe qëllimit të aktivitetit të prokurimit si të tillë, janë formuluar të gjitha kërkesat e kontestuara nga parashtruesi sipas dosjes së tenderit ku përfshihen por nuk kufizohen kërkesat për stafin e punonjësve, arkeologun, ekspertin për restaurimin e monumenteve, certifikatat ISO, dhe/ose dëshmitë tjera dokumentare. Sa i përket kërkesës për të dorëzuar dokumentet përkatëse si kopje të vërtetuara nga noteri – vërtetimit noterial, duhet cekur se këto kërkesa nuk janë aspak diskriminuese dhe/apo favorizuese sepse secili tenderues pa përjashtim e ka mundësinë që të noterizoj dokumentet te noteri pa përjashtim. Në anën kjo kërkesë është mjaft e domosdoshme sepse si e tillë parandalon përkatësisht nuk lejon mundësinë që operatorët ekonomik të dorëzojnë dokumente të falsifikuara ku mund të vendosin data apo të dhëna mashtruese me qëllim të vënies së autoritetit kontraktues në lajthim.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.05.2024

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.